



INSTITUTI ALB-SHKENCA

NË BASHKËPUNIM ME

**FAKULTETIN EKONOMIK E FAKULTETIN JURIDIK TË
UNIVERSITETIT TË PRISHTINËS "HASAN PRISHTINA"**

DHE ME

**MINISTRINË E ARSIMIT, TË SHKENCËS DHE TË TEKNOLOGJISË
TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS**

THIRRJE

për kumtesa dhe pjesëmarrje në

**TAKIMIN XII VJETOR NDËRKOMBËTAR
TË INSTITUTIT ALB-SHKENCA**

Në Prishtinë, prej 1 deri më 3 shtator 2017

Instituti Alb-Shkenca, strukturë shkencore joqeveritare e jofitimprurëse që bashkon studiues të gjitha disiplinave nga diaspora e nga mbarë trojet shqiptare në Ballkan, institucioni i parë shkencor gjithëshqiptar dhe më i madhi deri më tash, njofton fillimin e përgatitjeve për Takimin XII Vjetor Ndërkombëtar të tij.

Takimi XII i Institutit Alb-Shkenca do t'i zhvillojë punimet në Prishtinë, në mjediset e Fakultetit Ekonomik e të Fakultetit Juridik të Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina", prej 1 deri më 3 shtator 2017.

Ftohen anëtarët e Institutit Alb-Shkenca dhe të gjithë studiuesit e tjerë nga strukturat akademike shqiptare nga rajoni dhe diaspora, kërkuesit shkencorë të pavarur, si dhe shkencëtarët e huaj të lidhur ose jo me çështjet shqiptare, të marrin pjesë në këtë tubim të madh shkencor.

Në pajtim me frymën dhe traditën e Institutit Alb-Shkenca, të interesuarit janë të ftuar të kumtojnë në Takim arritjet e tyre më të reja në fushat specifike të hulumtimit e të ekspertizës.

KONFERENCAT SHKENCORE NË KUADËR TË TAKIMIT XII

- I. Konferenca ndërdisiplinore e terminologjisë**
- II. Konferenca e Seksionit të Shkencave të filologjisë, të historisë e të kulturës**
- III. Konferenca e Seksionit të Shkencave të drejtësisë**
- IV. Konferenca e Seksionit të Shkencave të bujqësisë**
- V. Konferenca e Seksionit të Shkencave të mjedisit dhe Shkencave të natyrës**
- VI. Konferenca e Seksionit të Shkencave të ekonomisë**
- VII. Konferenca e Seksionit të Shkencave të mjekësisë:**
- VIII. Konferenca e Seksionit të Shkencave inxhinierike dhe të teknologjisë së informacionit**
- IX. Konferenca "Informatika në shkencat e tjera"**
- X. Konferenca e Seksionit të Shkencave shoqërore dhe politike**

PRITEN EDHE AKTIVITETE TË TJERA për të cilat do të informoheni në faqen e zyrtare të Institutit Alb-Shkenca

DËRGIMI I PUNIMEVE

Përmbledhjet e punimeve për botim sipas Sesioneve

- Përmbledhja në shqip dhe në gjuhën angleze
- **Përmbledhja duhet të përmbajë 500 - 800 fjalë**
- Përmbledhja duhet të përmbajë: titullin, autorin kryesor, bashkautorët dhe adresat e tyre të emailit; dhe duhet të tregojë qëllimin e punimit, metodën e përdorur dhe përshkrimin e rezultateve, si dhe përfundimet kryesore

Data me rëndësi

Dërgimi i përmbledhjeve.....deri më 31 maj 2017
Shpallja e punimeve të miratuara:.....deri më 30 qershor 2017
Pagimi i kuotizacionit së pjesëmarrjesderi më 20 gusht 2017

Pagesa e pjesëmarrjes në Takimin XII

- Për anëtarët e IASH-it: 50 Euro
- Për pjesëmarrësit e tjerë: 60 Euro

Nëse pagesa **në Takimin XII** nuk bëhet në llogarinë bankare brenda datës 20 gusht 2016, pagesa "on desk" për të gjithë pjesëmarrësit do të jetë 100 Euro.

Pagesa duhet bërë në llogarinë e Institutit Alb-Shkenca në ndonjërin nga filialet e BKT-së

Pjesëmarrësit nga Shqipëria

BKT - Tiranë për Institutin Alb – Shkenca

Nr. llogarisë: 507360001

IBAN: AL8420511571360001CLTJCFEURA

SWIFT: NCBAALTX

Pjesëmarrësit nga Kosova

Banka Kombëtare Tregtare Kosovë

Nr. i llogarisë: 1901378968031154

Pjesëmarrësit nga Maqedonia

Procredit Banka – Shkup_Alb – Shkenca

Nr. i llogarisë: 380 – 1 – 261336 – 001 – 34 (në denar)

IBAN: / MK07380126133601298 (në valute të huaj)

ProCredit Bank, Macedonia

SWIFT: PRBUMK 22XXX

Pjesëmarrësit nga Diaspora

Në ndonjërën nga llogaritë e më sipërme bankare

INFORMACIONE SHITESË PËR TË INTERESUARIT

Kumtesat duhet të jenë origjinale (të pakumtuara në ndonjë aktivitet tjetër), të pabotuara dhe jo në proces vlerësimi ose botimi (në ndonjë redaksi tjetër).

Një autor, mund të paraqitet në Takim me më së shumti **2 (dy) punime**.

Përmbledhjes së kumtesës duhet t'i prijë shënimi se në cilën konferencë dëshironi të paraqiteni.

Përmbledhja e kumtesës duhet të jenë formatuar sipas formatit të rregullave të IASH-it, që mund t'i shihni në faqen e Takimit në [www:alb-shkenca.org](http://www.alb-shkenca.org)

Autorët janë përgjegjës për redaktimin gjuhësor të tekstit të përmbledhjeve të tyre.

Kumtesat dhe i gjithë komunikimi gjatë Takimit XII do të zhvillohen në gjuhën shqipe ose angleze.

Përmbledhjet duhen regjistruar **ON LINE** nëpërmjet sistemit **ALPA**, në adresën:

<http://iash-takimet.org> (shqip) ose <http://iash-meetings.org> (anglisht)

INFORMACIONE RRETH PUBLIKIMIT TË PËRMBLEDHJEVE DHE PUNIMEVE

Të gjitha përmbledhjet e regjistruara ON LINE nëpërmjet sistemit **ALPA**, në adresën:

<http://iash-takimet.org> (shqip) ose <http://iash-meetings.org> (anglisht)

sipas rregullit të IASH-it rishikohen nga recensentët përkatës sipas mënyrës double-blind të recensimit (recensenti nuk e di se e kujt është përmbledhja e punimit e autori nuk e di se kush ia ka recensuar përmbledhjen e punimit).

Të gjitha përmbledhjet e pranuar, për pranimin lajmërohen të gjithë autorët, përgatiten nga sistemi dhe dalin si libër i veçantë (versioni letër dhe versioni elektronik) me titullin **Libri i Përmbledhjeve të Konferencës (Conference Proceeding Book)** me numrin përkatës ISBN.

Punimet e prezantuara në Konferencën përkatëse të Takimit XII duhet të përgatiten sipas formatit të IASH-it e edhe të regjistrohen ON LINE nëpërmjet sistemit **ALPA** në adresën:

<http://iash-takimet.org> (shqip) ose

<http://iash-meetings.org> (anglisht)

sipas rregullit të IASH-it të gjitha punimet e plota të regjistruara rishikohen nga recensentët përkatës sipas mënyrës double-blind.

Të gjitha punimet e plota të pranuar, për pranimin lajmërohen të gjithë autorët, përgatiten për shtyp dhe publikohen në numrin përkatës të Vëllimit X të revistës shkencore AKTET e cila ka numrin ISSN të versionit letër dhe del në disa numra varësisht nga numri i punimeve të pranuar, e versionet elektronike të punimeve veç e veç vendosen në faqenueb të IASH-it që të mundë të indeksohen.

Revista shkencore e Institutit Alb-Shkenca AKTET drejtohet nga prof. Robert Magari, Beckman Coulter Inc., Florida, SHBA. Revista shkencore AKTET ka bordin editorial/botues ndërkombëtar, dhe i plotëson të gjitha kushtet e revistës shkencore prestigjioze. Revista shkencore AKTET ka filluar të dalë më 2008, dhe në të publikohen Punimet e plota të Takimeve të Institutit Alb-Shkenca.

Këshilli organizues